



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 799/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Dr.sc. Rafet Haxhaj Kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Adnan Konushevcu anëtar, me pjesëmarrjen e Zytarit Ligjorë Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi me apelin e parashtruar nga Nusret Maholli, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal nga subjekti politik AAK, me seli në Prishtinë, dega në Lipjan, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 11.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si i pabazuar apeli i parashtruar nga Nusret Maholli, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Lipjan, nga radhët e subjektit politik AAK me seli në Prishtinë, dega në Lipjan, me shenjën ZL.Anr.799/2017, të datës 09.11.2017, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datë 09.11.2017 në ora 17:10, nga Nusret Maholli, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Lipjan, nga radhët e subjektit politik AAK me seli në Prishtinë, dega në Lipjan, me të cilën pretendon se në Lipjan në fshatin Gadime e Ulët, në Qendrat e Votimit QV nr.1307e, 1307e/01R, 1307E/03R, 1307/04R, 1307/06R, 1307E/07D, 1323E/01R, 1323E/02R, 1323E/03R, 1302E/02R, 132B/04D, 1302E/05R, 1302E/06D, 1317/01R, 1317E/04D, 1306E/02R, 1306/03D, nuk përputhen rezultatet e votave në mes të Formularit të Rezultateve Përfundimtare dhe Formularit të Rezultatit të Kandidatëve, duke theksuar se ka pasur pa rregullsi lidhur me procesin e numërimit të votave.

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë së apelit dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli vlerëson se parashtruesi i apelit në apelin e parashtruar nuk e ka potencuar se sa vota i mungojnë në Lipjan në fshatin Gadime e Ulët, në Qendrat e Votimit QV nr.1307e, 1307e/01R, 1307E/03R, 1307/04R, 1307/06R, 1307E/07D, 1323E/01R, 1323E/02R, 1323E/03R, 1302E/02R, 132B/04D, 1302E/05R, 1302E/06D, 1317/01R, 1317E/04D, 1306E/02R, 1306/03D si dhe në mbështetje të pretendimeve ankimore në apel nuk ka ofruar asnjë dëshmi për të vërtetuar pretendimet në apel i parashtruar, në kuptim të nenit 117 par. 3 të LZP-së, ku është përcaktuar: *“se vendosja për ankesa dhe apele nga PZAP-i mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*. Paneli gjatë vendosjes për një apel i shqyrton dhe i heton me kujdes të gjitha provat e bashkangjitura në apel dhe kur vlerëson se pretendimet ankimore nuk janë të provuara me prova nga parashtruesi i apelit, siç është në rastin konkret, ku parashtruesi i apelit nuk e ka bashkangjitur asnjë provë lidhur me pretendimet e tij, e refuzon apelin si të pabazuar.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)

Anr.799/2017 më datën 11.11.2017.

Kryesuesi i Panelit

Dr.sc. Rafet Haxhaj

Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*